

Të huajt dhe azilkërkuesit në Shqipëri

Viti 2018

Tiranë, më 22 Gusht 2019: Në 2018, numri i të huajve me leje qëndrimi në Shqipëri rezultoi 14.162 banorë, duke shënuar rritje me 9,7 %, krahasuar me 2017.

Numri i të huajve rezidentë, në vitin 2018, përbëhet nga 9.203 meshkuj, duke shënuar rritje me 9,9 % krahasuar me 2017, dhe 4.959 femra duke shënuar rritje me 9,6 % krahasuar me 2017.

Të huajt me origjinë nga Europa, gjatë vitit 2018, janë 8.212 dhe përbëjnë 58,0 % të të huajve gjithsej kundrejt 59,2 % që përbënin në 2017.

Në vitin 2018, arsyet kryesore të lejeve të qëndrimit janë arsyet për punësim dhe bashkim familjar, të cilat së bashku zënë 72,4 % të arsyeve të të huajve rezidentë gjithsej.


Janë evidentuar 6.893 të huaj të parregullt, ku pjesën më të madhe të tyre, 44,8 % e zënë të huajt me origjinë nga Siria.

Gjatë 2018, rezultojnë 4.386 azilkërkues në Shqipëri, ku pjesën më të madhe të tyre, 49,0 % e zënë të huajt me origjinë nga Siria.

Në 2018, rezultojnë 345 persona të cilët kanë fituar shtetësi shqiptare, duke pësuar rritje me 9,2 %, krahasuar me vitin 2017.

Personat të cilët kanë humbur shtetësinë shqiptare gjatë vitit 2018, janë 640, duke pësuar rënie me 1,7 %, krahasuar me vitin 2017.

Fig. 1 Të huajt me leje qëndrimi sipas gjinisë




Të huajt në Shqipëri

Numri i të huajve me leje qëndrimi në Shqipëri, në vitin 2018, përbën rreth 0,5 % të popullsisë rezidente. Gjatë 2018, numri i të huajve rezident përbëhet nga 9.203 meshkuj dhe 4.959 femra. Meshkujt zënë 65,0 % në numrin e të huajve me leje qëndrimi në Shqipëri.

Piramida e të huajve rezidentë në Shqipëri pasqyron qartë një disbalancë gjinore, dhe femrat kanë një moshë relativisht më të re se meshkujt.

Fig. 2 Piramida e popullsisë së huaj rezidente në Shqipëri



Burimi: Departamenti për Kufirin dhe Migracionin

Numri i aplikimeve për leje qëndrimi në Shqipëri, në vitin 2018, është 9.090 aplikime, duke shënuar një rritje me 0,7 %, krahasuar me vitin 2017. Aplikimet sipas vendit të origjinës nga Irani, Italia dhe Kosova përbëjnë 63,8 % të aplikimeve gjithsej në 2018.

Tab. 1 Aplikimet për leje qëndrimi në Shqipëri sipas vendit të origjinës

Vendi i origjinës	2017	2018
Iran	1.963	2.223
Itali	1.779	1.709
Kosove	978	996
Turqi	863	875
Greqi	295	207
SHBA	280	350
Kinë	259	213
Siri	229	260
Maqedoni	167	154
Mbretëri e Bashkuar	152	132
Tjetër	2.062	1.971
Gjithsej	9.027	9.090

Burimi: Departamenti për Kufirin dhe Migracionin

Të huajt në Shqipëri sipas kontinenteve


Të huajt me leje qëndrimi në Shqipëri sipas vendit të origjinës në 2018, kryesohen nga vendet e Europës, të cilët zënë 58,0 % të të huajve gjithsej.

Të huajt me origjinë nga Europa janë 8.212, duke shënuar një rritje me 7,5 %, krahasuar me 2017.

Të huajt me origjinë nga Azia janë 4.022, duke shënuar një rritje me 11,2 %, krahasuar me 2017.

Të huajt me origjinë nga Amerika, Afrika dhe Oqeania janë 1.928, duke pësuar një rritje me 16,8 %, krahasuar me 2017.

Fig. 3 Të huajt me leje qëndrimi sipas kontinenteve




Burimi: Departamenti për Kufirin dhe Migracionin

Të huajt në Shqipëri sipas arsyes

Në vitin 2018, sipas arsyes, të huajt që aplikojnë për leje qëndrimi për punësim zënë 49,1 % të të huajve gjithsej, ndjekur nga aplikime për bashkim familjar me 23,3 %, aplikime për qëllime humanitare me 18,1 %, aplikime për studime me 4,5 % dhe aplikime për arsye të tjera me 5,1 %.

Fig. 4 Të huajt me leje qëndrimi sipas arsyes, 2018



Të huajt e parregullt

Të huajt e parregullt të evidentuar në territorin e Shqipërisë ose në kufi, pa dokumentacionin e nevojshëm rezultojnë 6.893 persona në 2018, kundrejt 1.049 personave në 2017.

Të huajt e parregullt sipas vendit të origjinës në 2018, kryesohen nga vende si Siria me 3.089 persona, Pakistani me 1.246 persona, Iraku me 671 persona, Palestina 395 persona, Algjeria 378 persona, Maroku 344 persona dhe 770 persona nga vende të tjera.

Azilkërkuesit në Shqipëri

Azilkërkuesit në Shqipëri, referuar Drejtorisë së Azilit dhe Shtetësisë pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, rezultojnë 4.386 persona në 2018, kundrejt 309 azilkërkuesve në 2017.

Duke analizuar vendin e origjinës së azilkërkuesve në 2018, kuptojmë se shumicën e rasteve e përbëjnë ato me origjinë nga Siria, me 2.150 azilkërkues, nga Pakistani 645 azilkërkues, nga Iraku 447

azilkërkues, nga Palestina me 292 azilkërkues, nga Algjeria me 227 azilkërkues dhe nga Maroku 227 azilkërkues.

Gjatë 2018, rezultojnë 16 vendime pozitive për dhënie të statusit të refugjatit dhe statusit të mbrojtjes plotësuese për azilkërkuesit, ku shumica e tyre vijnë nga vende si Palestina.

Gjatë 2018, rezultojnë 78 vendime pezullimi dhe pushimi për azilkërkuesit, ku shumica e tyre vijnë nga vende si Siria.

Marrja dhe lënia e shtetësisë Shqiptare

Në 2018, rezultojnë 345 persona të cilët kanë fituar shtetësi shqiptare, duke pësuar rritje me 9,2 %, krahasuar me vitin 2017.

Në 2018, rezultojnë 640 persona të cilët kanë hequr dorë nga shtetësia shqiptare, duke pësuar rënie me 1,7 %, krahasuar me vitin 2017.

Metodologjia

Publikimi i të huajve dhe azilkërkuesve në Shqipëri ka periodicitet vjetor. Qëllimi i tij është paraqitja e rezultateve dhe treguesve mbi të huajt me leje qëndrimi në Shqipëri sipas grupmoshave dhe gjinisë, arsyes së aplikimit, vendeve të origjinës si dhe numrin vjetor të aplikimeve të lejeve të qëndrimit. Publikimi paraqet gjithashtu, rezultate dhe tregues mbi të huajt e parregullt, azilkërkuesit dhe fitimin apo lënien e shtetësisë Shqiptare.

Të dhënat mbi të huajt me leje qëndrimi në Shqipëri si dhe të huajt e parregullt sigurohen nga Departamenti për Kufirin dhe Migracionin.

Të dhënat mbi Azil Kërkuesit dhe fitimin ose lënien e shtetësisë në Shqipëri sigurohen nga Drejtoria e Azilit dhe Shtetësisë në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Përkufizime

I huaj është çdo person, me ose pa shtetësi, i cili, sipas legjislacionit shqiptar, nuk është shtetas shqiptar.

Leje qëndrimi është dokumenti i lëshuar nga autoritetet kompetente, i cili autorizon dhe lejon të huajin të qëndrojë në Republikën e Shqipërisë më shumë se 90 ditë brenda 180 ditëve.

Person pa shtetësi është personi, i cili nuk ka shtetësinë e asnjë shteti.

Leje pune është autorizimi i lëshuar nga autoriteti shtetëror përgjegjës, një të huaji, për qëllime biznesi, për t'u punësuar, vetëpunësuar ose për formim profesional.

Bashkim familjar është hyrja dhe qëndrimi në Republikën e Shqipërisë të anëtarëve të familjes së një shtetasi shqiptar, të cilët nuk kanë shtetësinë shqiptare, ose të një të huaji, ose refugjati, banorë në Republikën e Shqipërisë, me synim ruajtjen e familjes, pavarësisht nëse marrëdhënia familjare krijohet para apo pas hyrjes së të huajit në Republikën e Shqipërisë, në rastet e bashkimit familjar të familjes së të huajit.

Anëtarë të familjes së të huajit, azilkërkuesit, refugjatit apo personit nën mbrojtje plotësuese janë bashkëshorti/bashkëshortja, bashkëjetuesit/bashkëjetuesi, bashkëjetesa e të cilit ka një karakter të qëndrueshëm dhe të provuar; të miturit, fëmijët e pamartuar, pjesë e përbërjes familjare, përfshirë dhe ata të vendosur në regjim të kujdestarisë dhe që janë në ngarkim të tij ose të saj apo të birësuar me vendim gjykatë apo një vendimi që zbatohet drejtpërdrejt, sipas detyrimeve ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë ose që duhet të njihet, në përputhje me detyrimet ndërkombëtare, si dhe fëmijët e rritur, të pamartuar, kur ata nuk mundin objektivisht të plotësojnë nevojat e tyre, për shkak të gjendjes së tyre shëndetësore; paraardhësit e shkallës së parë në linjë të drejtë, kur janë në ngarkim të tij, ose bashkëshortes/bashkëshortit, sipas legjislacionit të origjinës dhe nuk gëzojnë mbështetjen e duhur familjare në vendin e origjinës.

Shërbimi vullnetar është një program aktiviteteve solidarizuese, bazuar në veprimtari të njohura në Republikën e Shqipërisë, në zbatim të objektivave të interesit të përgjithshëm.

Studiues dhe specialistë janë të huajt që kanë njohuri të specializuara, thelbësore, për shërbimin, pajisjet kërkimore dhe nivel të lartë kualifikimi për aktivitetin që ushtron ndërmarrja ose institucioni kërkimor.

Qëndrim i parregullt është prania në territorin e Republikës së Shqipërisë të një të huaji, i cili nuk plotëson, ose nuk plotëson më kushtet për hyrje, qëndrim ose banim në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Shtetësia shqiptare fitohet, rifitohet, humbet apo lihet në përputhje me dispozitat e ligjit, i cili respekton normat e parimet e njohura të së drejtës ndërkombëtare në fushën e shtetësisë të pranuar nga Republika e Shqipërisë.

Marrja e shtetësisë fitohet nga një i huaj që ka paraqitur kërkesë për marrjen e shtetësisë shqiptare, në rast se plotëson kushtet e paracaktuara në ligj.

Lënia e shtetësisë shqiptare nënkupton se pasja e shtetësisë shqiptare merr fund sipas kërkesës së personit, kur ai plotëson kushtet e paracaktuara në ligj.

Azil është forma e mbrojtjes ndërkombëtare që Republika e Shqipërisë u jep refugjatëve.

Kërkesë për azil është çdo deklaratë e të huajit ose personit pa shtetësi, e shprehur në çfarëdolloj mënyre e në çfarëdo kohe përpara autoriteteve kompetente në pikat e kalimit kufitar apo brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, i cili kërkon mbrojtje ndërkombëtare, sipas konventave ndërkombëtare dhe legjisllacionit shqiptar.

Aplikim për azil është kërkesa zyrtare e të huajit ose personit pa shtetësi para autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët, e cila vlerësohet si një kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare, sipas Konventës së Gjenevës së OKB-së, "Mbi statusin e refugjatit". Çdo kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare vlerësohet si aplikim për azil, përveç rastit kur i huaji kërkon qartazi një lloj tjetër mbrojtjeje, për të cilën aplikohet veçmas.

Azilkërkues është çdo i huaj apo person pa shtetësi, që shpreh në çfarëdolloj mënyre se nuk dëshiron të kthehet në vendin e tij, si dhe çdo i huaj apo person pa shtetësi që ka paraqitur një aplikim për azil në Republikën e Shqipërisë, për të cilin nuk është marrë ende një vendim përfundimtar.

Shtet apo vend i origjinës është shteti, shtetësinë e të cilit mban azilkërkuesi apo refugjati dhe, në rastin e personave pa shtetësi, shteti në të cilin refugjati apo azilkërkuesi ka vendbanimin e tij të zakonshëm.

Status i mbrojtjes plotësuese është njohja nga autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët në Republikën e Shqipërisë i të huajit ose personit pa shtetësi, si person i pranueshëm për mbrojtje plotësuese.

Status i refugjatit është njohja nga autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët në Republikën e Shqipërisë i shtetasit të huaj ose personit pa shtetësi si refugjat.